

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 178, Gusht 2018

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

2 THETHI ESHATI MË PERËNDIMORE I SHQIPËRISË ORIENTALE

Krijuesi kur bëri Thethin i fali bujarisht gjithë mirësinë, hijeshinë dhe madhështinë e një monumenti të pa shoqë q sa çdo poet dhe shkrimtarë e ka të vështirë të gjejë fjalët dhe vargjet që meriton kjo "nudo" e përsosur e natyrës sonë alpine.

Thethi është unikal dhe si ai nuk ka të tjerë toka e shqipeve...



7 PULTI PËRKUJTON DHE FESTON

Përkujtimi i 103-vjetorit të luftës së Planit, një nder ngjarjet më të lavdishme të Dukagjinit rreth shekullit XX, kundër ushtrisë Malazeze, pat dy të veçanta, që i dhanë një panoramë shumë të këndshme festive. Në këtë manifestim festiv ishin shumë të ftuar nga ...



4 Nuk duhet të na kushtëzojë e kaluara të ardhmen tonë ...

4

- Mendime mbi vëllimin e IV "Dita e plisit" -

I nderuar Ismet Krasniqi-Lala! I nderuar Prend Buzhala! Të nderuar të pranishëm! Kënaqësi e veçante të jem pjese e kësaj veprimtarie dhe të them opinionin tim për punën që kanë bërë dhe bëjnë Ismeti e Predi, por dhe ndihmësit e tyre, Idrizi e Gjoni. Të gjithë botimet janë të plotësuar me materiale mjaft edukative, në veçanti për brezat e ardhshëm. Por unë po ndalem në volumnin e IV të këtij libri: "Dita e Plisit". Një shkrimtar i madh Irlandez, Oscar Wilde, theksonte: "Askush s' është aq i pasur sa të blejë të kaluarën e tij!". E bukur dhe me shumë domethënie, megjithëse jo në pak raste kanë bërë e bëjnë përpjekje të na marrin të kaluarën, madje pa asnjë shpërblim.

6 BARDHËSI PLISASH NË KULLËN E ZAHIR PAJAZITIT

NË ORLLAN TË BESIANËS U SHËNUA "DITA E PLISIT"

Me këtë rast u bë përrurimi i librit "Dita e plisit" të katër edicioneve të kaluara (Vëllimi i I, II, III, IV) të autorëve Ismet Krasniqi dhe Prend Buzhala.



NË KUADRIN E KONKURISIT TË "VITIT TË SKËNDERBEUT 2018"

9 Funkioni ushtarak i Schaputarit në shek XIV-XV dhe roli i "Rilindjes Kulturore" në dekadat e fund shek XIX për emërtimin e ri kombëtar Shqipëri

9

THETHI FSHATI MË PERËNDIMORE I SHQIPËRISË ORIENTALE

Krijuesi kur bëri Thethin i fali bujarisht gjithë mirësinë, hijeshinë dhe madhësinë e një monumenti të pa shoqë aq sa çdo poet dhe shkrimtarë e ka të vështirë të gjejë fjalët dhe vargjet që meriton kjo “nudo” e përsosur e natyrës sonë alpine.

Thethi është unikal dhe si ai nuk ka të tjerë toka e shqipeve.

Thethi edhe pse i stolitur me kurorën mbretërore të bukurisë dhe i veshur me vellon e bekuar të virgjërisë është një jetim i pa fat, fukara i diskriminuar historikisht nga qeveritë Shtërpica 100 vjeçare të Shqipërisë. Dje dy Prishtinase hirplote si muzat alpeve të mrekulluara deri në ekstaze nga përqaftimi gryka-gryka me natyrën Thethit u shprehën: - Lavdi Zoti që ka bërë këtë parajsë! Mallkuar qofshin qeveritë që kanë lënë me këtë rrugë të shëmtuar! Është folur e stërfalur, shkruar e stershkruar, qare e vajtuar dhe defekto Thethi kryefjala e verimit (turizmit) malorë shqiptare ka mbetur akoma me rrugën e Spiro Kolekës të çelur para çlirimt. E kam bërë këtë rrugë edhe në kohën e monopartizmit e pa asfaltuar ishte, por ama ishte me parametra njerëzore. Ka 28 vjet që lehim si qeni në hanë për t'u integruar në Evropë dhe drumi më rrahur nga evropianet i Shqipërinë malore ka degraduar në një rrugë shtazore të ngjashme me rrugët e rezervateve afrikanë të gjuetisë të shekullit XIX: Shtylla ime kurrizore e operuar prej Herrjes Diskale e dënuar ta bëjë për arsye punë disa herë çdo javë mallkon papërgjegjshëm 28 vjeçare, prandaj nga dëshpërimi thotë “Rroftë Shoku Enver!!!” Gjithkush e bën qoftë edhe një herë të vetme rrugën e Dukagjinit ose shfryjë gjithë inat ose shanë ose mallkon. Një zonjë e një shoqate që mori pjesë në panairin e zhvilluar në Njësinë Administrative të Shoshit, me 9 korrik 2018 si natyraliste që ishte e bekoi ajrinë, ujin dhe freskinë e Mali të Shoshit, por nervozuar dhe dremitur nga tronditjet shkatërrimtare që shkaktonte fugoni nga përplasjet e pa reshtura në çdo metër në gropat e thella e gurët e thepisur bythë zbuluar lëshoj mallkimin. -Kurë mos shkelsha më në këtë rrugë! Të qahesh e mallkosh është dobësi.

Të kërkosh dhe luftosh për të drejtat më bazike të jetës tende të bashkësisë dhe shoqërisë tënde është detyrë humane sakrificë, trimëri dhe fisnikëri. Mjerisht trimëria shqiptare ka përfunduar në llumin më banal të larjeve të hesapeve individuale duke mos vrare kokën për as gjë ideale sociale as madhore.

ZA FEST THETHI 2018

E duam apo se duam me rrugë e pa rrugë, me drita e pa drita, me hap breshke apo dreri Thethi është dhe do mbetet fshati turistik më perëndimor i Shqipërisë.

Pas as një përkrahje qeveritare majtas as djathtas Thethi nuk ka dështuar, por ka rilindur në mënyrën e mundshme më

të vështirë. Ka rilindur falë kurajës, iniciativës, përvojës së fituar në mërgim, falë dashamirësisë imazhit dhe kulturës që kanë përcjellë në Zemër të Alpeve miqtë e vendeve më zhvilluara të Evropës. Edhe pse ndërtimet e Thethit mbajnë vulën e spontanitetit transit shqiptare nuk kanë përfunduar në shëmtira të pa korrigjueshme si ndërtimet e bregdetit, përjashtim bëjnë një pjesë e konsiderueshme çative, të cilat mund dhe e duhet të zëvendësohen me material druri.

Nuk e kam besuar deri sa kam parë vetë aderimet e brendshme ku dominon gjithkund druri, dhomat pa nevojtoje janë po thuaj drejt zhdukjes. Mënyra gatimit dhe shërbimit ka vend për përmirësime të theksuara, por edhe këtë thethjanët duket se janë treguar inteligjent dhe e kanë kuptuar shumë mirë, se çfarë ju pëlqen më shumë të huajve që në shumicën e rasteve nuk përputhen me shijet tona. Të ngopur deri në fytyrë me sitini dhe kuzhinën e vendeve nga vijtë prandaj ata preferojnë ato gjera që ata nuk i gjejnë lehtë në vendet e tyre. Në Bujtinat e Thethit komunikimin në gjuhë të huaj e kanë marrë në dore krejtësisht të ritë, ata janë shoqëruarit dhe udhërrëfyesit e tyre në çdo pikë ku ata dëshirojnë të shkojnë duke u integruar në mënyrën më të mirë.

Jo vetëm mua, por shumë kujt më ka bërë për përshtypje vajza e vogël 12 vjeçare e Prekë Bjeshkës, në Nderlysa, e cila komunikonte shumë lirshëm në çdo turist duke ju treguar se çfarë ju afronte bujtina e babait, merrte gjithë porositë bujtësve, por edhe ndihmonte nënën e saj duke shërbyer si fluturake e vockël. Sipas të dhënave të ministrisë që mbulon sektorin e turizmit, Thethi në bujtinat e tij ka një kapacitet prej 1500 shtretër. Në Theth në çdo tre vizitor dy janë të huaj kryesisht evropian. Thethi gjatë ditëve të pikut muajve korrik e gusht ka më tepër të huaj se sa banorë. Me datat 20-21-22-23 Korrik, ditët e “Za Fest Thethi 2018”, të gjitha vendet e bujtinave ishin të prenotuar, madje kishte dhe qindra çadra të sistemuar nëpër kampingjet kryq e tërthor Thethit. “Za Fest Thethi 2018”, me sukses shpalosi siparin e vet për të dytin vit radhazi duke qenë ndoshta veprimtaria me gjeografi më të gjerë me shumë kombesh në hapësirën Shqiptare. Koncerti ishte programuar në dy net me, meditime poetike, muzikë tradicionale të përpunuar, mozaik motivesh, rrymash dhe stilesh moderne nga më të pranishme në panairin internacionale muzikës ritmike. “Za Fest Thethi 2018” kishte edhe intermezo ushtrimesh aerobike juga dhe filma dokumentare. Skenografia, ndriçimi dhe efektet zanore ishin realizuar në

harmonitë të plotë me ambientin përfaqësues të lëndinës gjelbërore të Kishës së Thethit dhe kordonin shtatull gjerë të maleve karbonatike qiell prekëse e shkëlqim argjendta. Za Fest Thethi 2018 që përshfaqej me jehonën e vet të veçantë mes maleve të egra e kryelarta kishte sjellë me vetë dy gjeneratorë shurdhues, pasi Thethi përveç dritës së diellit dhe të hënës nuk ka energji të mjaftueshme për asgjë. Komedi shqiptare e radhës një koncert me vlerë mbi 100 milion lekë të vjetra prezantohet në një fshat turistik pa energji elektrike.

Rruga nga qendra e Thethit deri te kisha jo shumë se një km nuk ka emër tjetër një shëmtire të ndyrë, gjithë pluhur e ertë veniste me pa syri në derë të një perle të lënë më shumë në mëshirë të vdekurve se sa të gjallëve. Rilindja urbane dhe askush përpara saj nuk ka menduar as gjë deri më sot për qendrën e Thethit, ndërkohë që me të ashtuqajtura qytet që nuk behë kur qytete si Fushë Arrëzi, Laçi Va Dejsi apo fshati gjysmë turistik si Tamara qeveria është treguar mjaft bujare në raport me Thethin ndonëse që te tre këto qendra së bashku nuk vizitohen as 20 % në raport me Thethin.

Qilimi i blertë i livadhit i Kishës së



Thethit po drumiset pa mëshirë nga automjetet, njerëzit, kafshët, rrugënjat pa kontrolluara të banorëve rreth. Ajo sot ngjanë si një qilim gjithë njolla i pa larë i shkelur me këpucë të zhytura në hale, pa kurrfarë përkujdesje nga nuset dembelia të shtëpisë. “Za Fest Thethi 2018” ishte një natë spektakolare me e gjallënuhmja e këtij viti kalendarik. Emri më njohur ishte ai i Ema Andreas, e cila recitoj me klasë dhe ndjesi e motive të ndryshme lirike e shoqëruar nga tinguj e një muzike dhome (kitare).

Meditimi poetik duhej të ishte më i larmishëm, qoftë në përzgjedhje e poezive qoftë dhe zëra të tjerë recitues. Të recitosh në Theth e të mos ketë as një motiv nga Koliqi, Camaj, Reshpa apo edhe poetet e tanishëm do të thotë së nuk ke njohuri se ky truall kanë lindur mjeshtëra të mëdhenj të poetikës dhe prozës moderne të niveleve ndërkombe.

Të këndosh një tufë e gjerë këngësh me motive popullore nga trevat e tjera (me dominacë nga jugu) do thotë se ke harruar

se je në prehrin e legjendave të rapsodive kreshnike lahutës së butë qumështore të Dukagjinit. Natyrisht muzika moderne dhe ritmike kishte vendin e vet dominues i përshtatej më së miri publikut laraman shumëkombësh që rrinte i shkujdesur për shtatë palë qejfe mes lëndinës, në shtroja portative çante duke biseduar intimisht e pirë birra të markave të ndryshme, duke tymosur cigare, pse jo ndoshta të përzier me hashash, duke kërcyer gjithë energji, e puthur plot ëmbëlsi e pasion pa dorashka edhe brenda të njëjtit seks. “Za Fest Thethi 2018”, ishte montazh artistik i një jete nate, në një natë të vetme pa limit deri kur agoi mëngjesi 22 korrikut në Bjeshkën e Thethit, e cila duhet kthehet në traditë dhe të pasurohet shumë me tepër.

“Za Fest Thethi 2018” u shoqërua edhe me një panair të produkteve të Rajonit të Alpeve që duhet jetë akoma më larmishëm në produkte dhe cilësi reale produktesh. Panaire dhe turizëm pa rrugë lidhëse arteriale pash më pash të alpeve nuk mund të ketë. Spektakle të tilla ngjasojnë si aventura xhogleresh me xhakete me kollare, pa këmbishë pa pantallona.

“Za Fest Thethi 2018” ishte një buenë (rreke furishme gjate stuhive) birre çmimet e të cilave ishin vërtetë të kripura pasi në raste të tilla nuk pyetet sa kushton. Në zona turistike dhe ngjarje të tilla nate kudo ekziston parimi hyr në ta marrë mendja! Për se Thethi duhet të bëjë përjashtime?!

“Za Fest Thethi 2018” ishte një leksion shembullorë ku për dhjetë minuta pas përfundimit të koncertit u mbledh gjithë ajo rrgadhinë shishes, kanoçesh dhe ambalazhe nga më të ndryshmet dhe u sistemu

mua në qese të veçanta plastike. Ishin të huajt që bënë këtë, ndërsa rinia jonë e ardhur nga Mertopoli i Kryeqytetas dhe qytetet e tjera të mëdha jo vetëm që nuk çanë kokën të vijojnë edhe disa ore te tjera pas koncertit duke pirë pranë zjarreve, por nuk luajtën prapanicën vendit për të pastruar gjë. Por edhe kur ju tërhiq vëmendja nga forcat e policisë që shpërndaheshin dhe mos bënin zhurma se në bujtina doni të flinin pushuesit, filluan të kakarisën duke treguar lidhjet e tyre me njerëzit e politikës.

Gjithsesi çdo gjë shkoi shumë mirë pasi dasmë dhe feste pa alegro dhe pije nuk ka as nuk mund të ketë. Duke qenë edhe në funksion e drejtuesit të policisë në këtë bashkësi, falënderoi organizatorët dhe gjithë bashkësinë e Thethit për bujarinë, korrektësinë, dhe dashamirësinë që treguan në mbarëvajtjen e kësaj veprimtarie me numra katër shifror pjesëmarrësish.

Arkivat e Vatikanit e Kroacisë, zbulime për gramatikat e para të shqipes, që më 1700-n

54 GERMAT E SHKRUARA NGA NILO KATALANI. MARIJA DA LEÇE KA HARTUAR NJË GRAMATIKË TË SHQIPES NË ROMË MË 1716-N. MË 1776 SHQIPTARI PAL ZOGAJ PUNOI GRAMATIKËN E SHQIPES NË KROACI



Studiuesi Mark Palnikaj

Në shumë shkrime të studiuesve tanë është folur për shkrimin e pare shqip dhe për gramatikat e para të sajë. Kur është fjala për shkrimet e para në këtë gjuhë përmendet formula e pagëzimit e Pal Engjëllit e vitit 1463, Meshari i Gjon Buzukut, shkrimet e Bardhit dhe të Bogdanit, Nilo Katala-

këtë qytet. Në disa punime të publikuara më parë nga ana jonë kemi publikuar se Nilo Katalano, prift i rrit greko latin në Himarë ka kontribut me rëndësi për gjuhën shqipe. Sipas burimeve të dokumentuara që ruhen në Manastirin e San Nilos në Grottaferata, ky prift ka krijuar vetë një alfabet të shqipes me 54 karaktere, ka hartuar një gramatikë të gjuhës shqipe dhe ka hapur një shkollë me 100 nxënës shqiptarë.

IPANJOHURNGA GJUHËTARËT, ZBULIMI I NJË GRAMATIKE NË KROACI

Më vonë, Marija da Leçe, hartoi një gramatikë të gjuhës shqipe me titull "Osservazioni grammaticali della lingua Albanese", Romë 1716. Mbas kësaj date nuk flitet për ndonjë gramatikë të shqipes të hartuar nga ndonjë gjuhëtar

asaj kohe, sidomos të atyre me kombësi italiane që në 99 për qind të rasteve, në praktikën kishtarë, përdornin si mbiemër të tyre fshatin e origjinës.

Për aktivitetin e Pal Zogajt do të botojmë një punim të veçantë por në këtë punim do të prezantojmë punimin e tij për gramatikën e gjuhës shqipe në Kroaci në vitin 1776. Pal Zogaj më datë 20 shtator 1752, mbas përfundimit të studimeve në Universitetin Urbaniana të Vatikanit në degët e gramatikës, filozofisë dhe teologjisë, bëri betimin në gjuhën latine dhe shkroi "... Dëshmoj se jam Pal Bria nga Zogaj". Në përmbyllje të studimeve vlerësimi i tij nga eprorët ishte "Djalosh shumë i talentuar dhe me sjellje të mirë, dhe ka qenë gjithnjë shembullor". Mbasi bëri mëtimin u caktua të punojë në Ipeshkvinë e Shkupit si klerik dhe mbas pak kohe caktohet


trovicën e Sremit me 18 gusht të vitit 1769 dhe u firmos nga fon Lojtner. Listën me 7 kandidatë Komanda kryesore e Oborrit e nisi për në Vjenë me 26 gusht, kurse Këshillit luftarak të Oborrit iu paraqit më 4 shtator 1769.

Në shkollën e re u konsiderua e domosdoshme të kishte një mësues që të njohë gjuhën shqipe dhe mbas ndërhyrjes së Oborrit perandorak pranë Kongregatës së Shenjtë për përhapjen e fesë në Vatikan, u përzgjodh Don Pal Zogaj si personi më i përshtatshëm për këtë detyrë. Ky person kishte nivelin e nevojshëm të arsimimit, kishte punuar në zonën e Kelmendit dhe të Rugovës prej nga ishin të gjithë nxënësit e tij dhe e njihnte mire gjuhën dhe përveç kësaj, kishte punuar edhe në Janjevë. Me të filluar punë në këtë institucion, Don Pali kërkoi nga Kongregata e Shenjtë në Vatikan një pako

me libra për nevojat e shkollës dhe kërkesa iu plotësua menjëherë.

Ai filloi hartimin e një gramatike të gjuhës shqipe për nevojat e shkollës dhe mbas një procedure burokratike shumë të gjatë dhe një kontrolli të imtësishëm nga organet perandorake austro-hungareze, ajo u miratua për botim. Më datën 13 maj 1776, në adresë të Këshillit Mbretëror Kroat, arriti vendimi me shkrim i Mbretëreshës në të cilin bëhej me dije se botuesi i Oborrit Mbretërorë Trattner është i detyruar që në shtypshkronjën e tij në Varazhdin të bëjë shtypjen e Gramatikës Shqipe të Zogajt.

Ne nuk kemi arritur të kemi një kopje të kësaj gramatike, as dorëshkrim, as të shtypur, por me kërkimet e mëtejshme mund të sigurohet kopja dhe të publikohet ky dokument me rëndësi kombëtare dhe gjuhësore për evolucionin e gjuhës shqipe ndër shekuj. Pal Zogaj, sipas dokumenteve që disponojmë deri më sot, është shqiptari i parë që ka hartuar një gramatikë të gjuhës shqipe. Së shpejti do të publikojmë të dhëna më të hollësishme për jetën dhe veprimtarinë e Don Pal Zogajt.



Dokument: "Betimi i Don Pal Zogajt, Romë, 20 shtator 1752" Burimi: Arkivi i Kolegjit Urbaniana në Vatikan dhe Frrok Zefi, "Shqiptarët këlmendas në Hrtkocv dhe Nikinc 1737 - 1997, Zagreb 1997, faqe 104.

no dhe në shekullin XVIII përmendet Maria Da Leçe si hartues i fjalorit dhe i një gramatike të gjuhës shqipe.

Në asnjë rresht të punimeve të realizuara mbi këtë temë nga studiuesit e fushës si Nilo Borxhia, Mario Roku, Jup Kastrati, Dhimitër Shuteriqi, Rexhep Ismajli dhe disa studiues të tjerë nuk përmendet emri i Don Pal Zogajt, i cili ka hartuar një gramatikë të gjuhës shqipe për nevojat e shkollës ku jepte mësim në Osijek për fëmijët shqiptar nga Kelmendi që shkolloheshin në

shqiptar ose i huaj. Por studjuesi Don Frrok Zefi me shërbim për një kohë të gjatë në Kroaci, në studimet për shqiptarët dhe për traditat e tyre, ka zbuluar kontributin jashtëzakonshëm të Don Pal Zogajt për shkrimin e gjuhës shqipe. Emri i vërtetë i këtij kleriku, siç merret vesh nga arkivat e Universitetit Urbaniana të Vatikanit, shkruar me dorën e tij ishte Pal Bria, por mbasi ky ishte nga fshati Zogaj i Tropojës, ai prezantohej si Don Pal Zogaj, siç ishte zakoni për shumicën e klerikëve të

në Janjevë ku shumë vite më parë ishte hapur shkolla shqipe për përgatitjen e studentëve për të vazhduar studimet në kolegjet e Vatikanit në Itali.

Dokumentet që datojnë shtypjen e gramatikës së Zogajt në Kroaci

Me vendim të Komandës kryesore të Sllavonisë në Osijek u vendos që të merren shtatë të rinj shqiptarë për t'u shkolluar në këtë qytet. Urdhri për hapjen e shkollës u formulua në Mi-

Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, në promovimin e librave “Dita e Plisit”, të autoreve Ismet Krasniqi e Prend Buzhala, me 4 gusht 2018, në Orllan-Podujeve, në kullën e dëshmorit Zahir Pajaziti

Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, me ftese të organizatoreve të “Dita Plisit”, mori pjesë me një grup, Ndue Sanaj, Gjon Kosteri, Pal Lera, e Anton Kosteri.

Një takim shumë mbresëlënës, një takim në mes miqsh, në mes vëllezërish e motrash, me të cilët kemi kohë që jemi njohur, duke marrë pjesë në gjitha veprimtaritë e kësaj dite, të pagëzuar me emrin “Dita e Plisit”

Veprimtaria u hap me këngën majakrahit, nga rapsodi Nazmi Hajdari. Hapja vijoi me aktorin Ismet Krasniqi, siç e di vetëm ai, me duqit në supe: *“Mirë se keni ardhur në Kullën e Zahir Pajazitit, këtu në Orllan të Podujevës. Kam ardhur me duq në krah. Ju kujtohet çfarë funksioni kanë luajt duqit nëpër vite?! Me duq është mbajtur armë e barot, është mbajtur gjëra ushqimore e veshmbathje për familje; duqet kanë shpreh dashuri se nusja burrit i ka pru duqet me rrobe komplet të punuara me dorë, prej çorapeve, tlinave e këmishës të punuara në veke, shokës apo brezit, shallit e plisit. Me duq a hedh fara n'arë, me duq u kujtohen bijat-dadat tona kur kanë ardhur prej burrit në gjini kanë pru kuleç; a ju kujtohet çfarë ere mirë u*



vinte, ëëëmm.....po më duket edhe tani po ua ndie erën, era grua u vinte..... Por me duq është mbajtur edhe libri në gjuhen shqipe, e cila ishte e ndaluar nëpër vite nga armiqtë sundues në vendin tonë si

nga pushteti atoman turk, si nga regjimet shoviniste serbe, por megjithatë libri ka mbijetuar dhe ka triumfuar. prandaj në shenje respekti për librat në duq ua kam sjell librat që do të promovohen sot, librin

“Dita e Plisit”, të veprimtarisë së I, II, III dhe IV dhe për të gjithë ju të pranishmit do ta keni falas nga një kopje të tyre ...”, duke vijuar hapjen e takimit në emër të bashkëpunëtorëve të tij, Prend Buzhala, Idriz Berisha e Gjon Gjergjani.

Ndue Sanaj, Kryetari i SHAD, ligjëroj mbi përmbajtjen e librit të katërt “Dita e Plisit”. Pastaj, në emër të kryesisë së Shoqatës, dorëzoi titullin “**Mehmet Shpendi**” dhënë për dëshmorin Zahir Pajaziti, familjareve të tij.

Gjithashtu organizatoreve të veprimtarisë, Ismet Krasniqi-Lala, Prend Buzhala, Idriz Berisha-Xhixhi, Gjon Gjerjanit dhe poetëve Migena Arllati e Raif Gashi, ju dhuroj librin me titull “100 vjet arsim e kulture në Dukagjin”.

Organizatorët nderuan Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, titullin “MIRENJOHJA” për pjesëmarrjen e saj të herëpashershme në veprimtaritë e “Dita e Plisit”.

Veprimtaria u mbyll me një dreke me ushqime tradicionale.

Gjon Kosteri e Pal Lera

Nuk duhet të na kushtëzojë e kaluara të ardhmen tonë ..

- Mendime mbi vëllimin e IV “Dita e plisit” -

I nderuar Ismet Krasniqi-Lala! I nderuar Prend Buzhala! Të nderuar të pranishëm!

Kënaqësi e veçante të jem pjesë e kësaj veprimtarie dhe të them opinionin tim për punën që kanë bërë dhe bëjnë Ismeti e Predi, por dhe ndihmësit e tyre, Idrizi e Gjoni. Të gjithë botimet janë të plotësuara me materiale mjaft edukative, në veçanti për brezat e ardhshëm. Por unë po ndalem në volumin e IV të këtij libri: “Dita e Plisit”

Një shkrimtar i madh Irlandez, Oscar Wilde, theksonte: *“Askush s’është aq i pasur sa të blejë të kaluarën e tij!”*. E bukur dhe me shumë domethënie, megjithëse jo në pak raste kanë bërë e bëjnë përpjekje të na marrin të kaluarën, madje pa asnjë shpërblim.

Këta katër shqiptar, atdhetar, sigurisht të mbështetur nga shoqëria civile, nga miq e shoke, hulumtuan dhe nxorën në dritë nga “frigoriferi” i thelle i tokës një element të veshjes tradicionale tonë jo të thjeshtë, por mjaft të çmuar, që identifikon pellazgun, që identifikon Ilirianin, që identifikon shqiptarin, “Plisin e Bardhe”, emër të cilin e mësova për here të pare me 28 tetor 2015. Ata e menduan, e ideuan, e përgatiten dhe realizuan pesë veprimtari mbi këtë temë, mbi këtë objekt identifikues të shqiptarisë, të pagëzuar, me emrin “DITA e PLISIT”.

Gjithë materialet e se cilës veprimtari janë botuar në libra të veçante, duke filluar nga veprimtaria e pare, e dyte, e trete, e katër, te cilat i kemi në dore dhe po i promovojmë, por dhe të pestin do e kemi së shpejti në dore.

Në këtë vëllim ku të ndalem më pare?! Të ndalem te



Mehmet Rukiqi, i cili shkruan mbi historinë e lashte dhe në mes të tjerave thekson: “Në mitologjinë greke babai i pare i pellazgeve ishte njeriu i pare, që jetoi në botë, i cili kishte lindur nga dheu. Plisi në shkrimet kronologjike romake përfaqëson fëmijët e Zeusit. Ngjyra e bardhe e plisit është ngjyrë historike, që shpreh dritën dhe mbrojtjen hyjnore, është simboli ynë i shenjtë, paraqitet në ikonografi të ndryshme, afreska, relieve, monedha e skulptura e tjera. Ka histori të përbashkët me iliret dhe fiset e tyre pellazgo-ilire ...”.

Të vijnë më të ndalemë te Prend Buzhala, i cili thekson: “Gjithmonë plisi është konsideruar dhe konsiderohet shenjë e autoktonisë etnike shqiptare ... Nga ana tjetër, do përmendur dhe dy-tri fakte me peshë. Tashme plisi është eksponat muzeor nëpër muzetë etnografike e historike, nëpër muzetë kombëtare e nëpër ato të botës. ... Eshte nder i madh të mbash traditën ...!”

Të Muhamet D. Rogova, gjejmë një artikull shume kuptimplotë, të titulluar: “... Plisaxhiu më i ri nëpër vorbulën e jetës...”.

Apo, Daut Demaku, me teme “Funksionimi praktik i Plisit”, thekson: “Ne kemi obligim, në pikëpamje kombëtare e kulturore, t’i tregojmë botës, se kemi diçka që nuk e keni ju, se populli shqiptar para jush ka zbuluar se e ruan shëndetin mental të njeriut në pikëpamje civilizuese dhe në pikëpamje të pastërtisë”.

Apo, Brahim (Ibish) Avdyli, i cili me temën: “Përdorimi i Plisit gjate mijëvjeçareve dhe interpretimet tona”... thekson: “... Por, më e keqja është fakti shkencor, që “iliret shihen kryesisht si një popull në margjinat e civilizimit greko-romak” ... njëra arrin të përvetësojë plisin e bardhe, e tjetra shqiponjën me një koke, të cilat janë shenja të vete origjinës së kombit të madh botëror të ilireve..”, dhe vijon: ““Emërtimi shqiptar e shpreh simbolin shumë të lashte mitik – Shqiponjën dhe është aq e lashte sa edhe emërtimi pellazg apo ilir, dhe jo siç thuhet që nga shekulli i XV, siç e kualifikojnë disa studiues, të cilët nuk kane njohuri në besimin dhe mitologjinë e lashte, as nuk i njohin gjerat e gjuhës shqipe, e cila ka prejardhjen e lashte prej gjenezës së gjuhëve të botës, kur ishte mëma e të gjitha gjuhëve ...”. Gjithashtu vijon: “...Mbulesa e kokës në gjuhën shqipe quhet PLIS apo QELESHE dhe është një pjesë e denje sipas traditës së kombit shqiptar nder mijëvjeçare ... Kësula e bardhe është ajo që, me gjithë ndryshimet e formës të rrjedhura nga fisi (Kosova, Dibra, Shqipëri e Mesme, Myzeqe, Labëria) e dallon shqiptarin nëpër të gjithë Ballkanin (Gadishullin Ilirik). Ngjyra rrjedhe nga leshi i bardhe i dhënëve, me të cilin popullsia i end vete teshat e tij ... Plisi i bardhe quhej dhe kapela e njeriu të lire, sipas Justianit”.

Sa bukur thekson Hajdar Fejzullahu ...

Plisi! / Sa madhështi shpreh! / Sa histori tregon ai! I bardhe! / E po plisi është ai që do t’i rrënojë mitet e rreme serbosllave. / Plisi është vete historia, vete argumenti, vete lashtësia. Nuk është mit, por i vërtetë.

Por, në këtë vëllim, si dhe në vëllimet e tjera, nuk kemi vetëm identitet historik, por kemi dhe atdhetarizëm, lufte për jete



a vdekje me çdo pushtues për të ruajtur Lirinë, për të ruajtur Pavarësinë. Për këtë, ligjëruesi Besim Cengu, në mes të tjera thekson: “Në Galicë, te kulla e Azem Bejtes në ditën e Plisit”, frymëzohet dhe thur këto vargje: “Te kjo kulle lirie, edhe eshtrat flasin / eshtrat e ngulitura thelle në tokën ilire si rrënjë bunge pellazge / nga thellësia e tokës grafullon thirrja “O prite Azem Galicën, o hej / e jehona përcillet në pafundësi plis me plis / ndërsa kullës së famshme i nguliten themelet deri në palcën e dheut ...”.

Apo Bedri Tahiri ...Mbi jetën e Azem e

Shota Galica, që është botuar dhe në gazetën “Dukagjini”, nr. 170.

Të veçanta janë shkrimet portretizuese të Ismet Krasniqit për figurat, Nazmi Xh. Hajdari, Tahir Seferin, Ali Dacin e të tjerë.

Poezitë e autoreve të ndryshëm, janë shume domethënëse. Nëpërmjet vargjeve aq bukur kanë pasqyruar historinë e plisit, historinë e lashte të kombit tone, por mbi të gjitha veçoj poezinë, me titull “Një burrë i vogël me plis”, i autorit Ali Mulaj dhe e shoqëruar me një foto të kompozuar shumë mbresëlënëse, kushtuar vogëlushit

nga Gjakova, Argen Arllati

Unë nuk jam artist, për të recituar, por më lejoni të lexoj disa vargje të shkëputura të kësaj poezie:

Një burrë i vogël me plis / bir, nip e stërnip shqiptar / në bjeshkë madhështon si lis ...

Një burrë i vogël me tirq e gajtan / shqiponjën qëndisur ka n’ mitan /...

Gjashte muajsh një burrë i vogël ...

Mbi shpinë vitet e shekullit mbaj ...

Kënga në lahute e pushka e vjetër / në ballin e dhomës rrinë vare ...

Everestin s’ pata fat ta pushtoj / por sonte unë i përkas atij / sa Everesti djali të rrojë ,,,

e lum ama e vet që e mban në gji! ...

Më lejoni të ndalem në dy mendime:

Së pari, dikur lexoja, “Në qoftë se e ardhmja e pemës dhe rritja e saj lart janë mbi tokë, rrënjët janë nën tokë. Kjo do të thotë se e ardhmja ushqehet nga e kaluara. Të mjerët ata që nuk kultivojnë kujtimet e së shkuarës” Po, shumë filozofike, e drejtë, shumë e drejte, por në asnjë mënyrë nuk duhet të na kushtëzojë e kaluara të ardhmen tonë, për çka dua të theksoj, se pa harruar të kaluarën, pa harruar identitetin tonë kombëtar, të mendojmë për të ardhmen, të ecim përpara.

Së dyti, asgjë nuk është perfektë. Dhe kjo është fatmirësi, pasi në të kundërt rrugëtimi studimor do të merrte fund...Dhe unë do kisha dëshirën e madhe që në të gjitha botimet ku do botohen, në gjithë trevat Shqiptare të ruhej fondi i pasur i leksikut të gjuhës shqipe, pasi në disa vende të Evropës po ngrihen edhe Institute për Mbrojtjen e gjuhës së tyre. Gjuha identifikon kombet, identitetin, kulturën e zanafillën e tyre. Ne duhet ta ruajmë atë nga të gjitha interferencat e dëmshme, të cilat jo pak raste ndryshojnë shijen e këndshme të shqipes identitare.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Ndue Sanaj,

Podujeve, 4 gusht 2018



BARDHËSI PLISASH NË KULLËN E ZAHIR PAJAZITIT

NË ORLLAN TË BESIANËS U SHËNUA "DITA E PLISIT"

Me këtë rast u bë përrurimi i librit "Dita e plisit" të katër edicioneve të kaluara (Vëlimi i I, II, III, IV) të autorëve Ismet Krasniqi dhe Prend Buzhala

Kulla e Zahir Pajazitit në Orllan më 4 gusht kishte tubuar nga të gjitha anët e vendit plisbardashët që shënonin Ditën e Plisit, edicioni i pestë - pjesa e dytë. Ishte kënaqësi që aty të jesh ndër të parët dhe të vështrosh se si vinin mysafirët të gjithë të buzëqeshur me plisat në kokë dhe me vështrim nga shtatorja e të madhit Zahir dhe nga Kulla e tij. Shumë nga këta mysafirë ishin për herë të parë në këtë të privilegjuar që këtë ditë kishin pas fatin të gjenden aty.

Si zakonisht në këto manifestime aty arrin i pari ideatori i këtij manifestimi tashmë tradicional Ismet Krasniqi-Lala, për ti prit mysafirët që vinin me radhë. Pritja ishte e ngrohtë dhe miqësore. Aty vinin mysafirë nga të gjitha viset e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare po edhe nga Diaspora, madje edhe nga Australia. Këta të diasporës nuk mundnin ta fshehin gëzimin që kësaj radhe pasi patën fatin që të jenë në pushime në vendlindje dhe të marrin pjesë në këtë aktivitet me karakter kombëtar që kujton trashëgimin historike të popullit tonë.

Posa u tubuan të gjithë në këtë vend dhe vetëm pritej fillimi i manifestimit, të gjithë së bashku u drejtuan nga varri i Heroit Zahir Pajaziti dhe aty pranë varreve bënë nderime për jetën dhe veprën e heroit dhe gjithë të rënëve për liri. Prej aty më pas morën drejtimin dhe hynë në Kullën e Zahirit ku zunë vendet e tyre. vend dhe mahnitëshin me bukurit magjepse të kësaj ane dhe kur ato i kombinonin me historinë e lavdishme të heroit kombëtar Zahir Pajaziti nuk kishte se si të mos e ndjejnë vetën të kënaqur dhe

Kjo bardhësi plisash dhe këta njerëz të ardhur nga shumë vise shqiptare na kujton rrezet e lirisë që lëshonte Zahir nëpër të gjitha viset shqiptare në rrugëtimin e tij për mobilizimin e të rinjve për formimin e UÇK-së dhe luftën e saj të lavdishme për liri. Andaj falë asaj lufte dhe ndihmës së aleatëve tanë ne sot, tubohemi, kuvendojmë, këndojmë, vallëzojmë, recitojmë dhe të lirë jetojmë.

Dhe pa vonuar shumë në derë u shfaq Ismet Krasniqi bashkë me Nazmi Hajdarin duke kënduar këngë maje krahu që shënoi fillimin e manifestimit. Krasniqi në krah mbante një palë duq dhe pasi para të pranishmëve foli për rolin dhe rëndësinë e duqve se për çka kanë shërbyer në të kaluarën ndër tjera tha se ata

kanë shërbyer edhe për bartjen e librave dhe nga aty nxori librat "Dita e plisit" e i vendosi në sofrën e shtruar në ballë të oxhakut mbi të cilin qëndronte edhe mbishkrimi për manifestimin e sotëm.

Moderator të këtij aktiviteti ishin Ismet Krasniqi dhe Prend Buzhala të cilët e freskonin atmosferën më ndonjë pjesë humorit të lehtë (Lala) dhe me ndonjë citat të shkurt për kullat shqiptare dhe trashëgimin tonë (Buzhala).

Për librat që u përruruan "Dita e Plisit" I, II, III, IV folën Idriz Berisha, Migena Arllati dhe Ndue Sanaj, ndërsa me nga një fjalë rasti para të pranishmëve u paraqitën edhe Gjon Gjergjaj, Ramadan Mehmeti, Hajdar Fejzullahu, Halit Barani, Fahri Xharra, prof dr. Liman Rushiti, Milazim Kadriu, Shaban Zeneli nga Tropoja lexoi përshëndetjen e plakut 92 vjeçar, Shaban Nokshiqi drejtuar Ditës së Plisit dhe ekzekutoi me fyell një valle baritore ...

Ndërkaq poetët mërgimtar që ishin prezent në këtë manifestim, Ajet Shala, Neki Lulaj, Gjin Morina, Hysen Berisha lexuan nga poezi kushtuar plisit. Gjithë këtë aktivitet herë pas here e shoqëronte me këngët e tij me lahutë e sharki rapsodi i mirënjohur Nazmi Hajdari.

Me këtë rast Kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" nga Shkodra z. Ndue Sanaj në emër të Kryesisë së Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" Kullën e Zahir Pajazitit e nderoi me mirënjohjen dhe medaljen "Mehmet Shpendi".

Më pas organizatorët e Manifestimit "Dita e Plisit" ndanë disa mirënjohje për ata që kanë kontribuar për realizimin e të

gjitha manifestimeve të deritashme që nga manifestimi i parë i mbajtur në vitin 2014 në Muzeun privat "Agimet e Gjytetnisë" të pronarit Gjon Nikë Gjergjaj në Krushevë të Vogël, komuna e Klinës, i dyti në Kullën trashëguese tradicionale të Brahim Ukës, në Kullën e Zenel Berishës në Dobërdol të Klinës, i treti në Kullën muze të Vehbi Ukë Isufajt në Junik, i katërti në Kullën muze të Azem Bejtë Galicës në Galicë, i pesti (pjesa e parë) në Odën e Daut Ferataj në Uçë të Istogut, (pjesa e dytë) në Kullën e Heroit Zahir Pajaziti në Orllan të Besianës. Po ashtu me mirënjohje u nderuan edhe disa radio dhe TV që e kanë përcjell aktivitetin e këtij manifestimi gjatë këtyre pesë edicioneve e po ashtu edhe disa shoqata dhe individ që kanë pas bashkëpunim dhe kanë kontribuar sadopak për mbarëvajtjen e manifestimeve për Ditën e Plisit, në mesin e tyre edhe donatorët që kontribuuan për rregullimin e ambientit për mbajtjen e manifestimit në Kullën e Zahirit.

Për të gjithë pjesëmarrësit u shpërnda falas libri "Dita e Plisit" edicioni i IV-të. Po ashtu edhe gazeta e Shoqatës atdhetare "Dukagjini" botuar në Shkodër, e po ashtu edhe disa libra iu dhuruan organizatorit nga autorët pjesëmarrës të këtij manifestimi.

Nga këtu Ismet Krasniqi-Lala në emër të organizatorit dhe Halit Barani në emër të mikpritësit u bënë ftesë të pranishmëve që me 27 tetor të jenë në pjesën e tretët të manifestimit "Dita e Plisit" që do të mbahet në Kullën e Isë Boletinit në Shalë të Bajgorës.

Me këtë rast organizatori njoftoi se katër edicionet e kaluara i kishte organizuar dhe mbajtur me financa personale nga Këshilli themelues në krye me Ismet Krasniqin, ndërsa këtë vit MKRS ka ndarë mjete modeste financiare e organizatori pjesën më të madhe të tyre i ka parapa për përgatitjen e Dokumentarit filmik për pesë edicionet e manifestimit "Dita e Plisit".

Kullës së Zahir Pajazitit me këtë rast për nder të Ditës së Plisit iu dhurua shtroja e odës në vlerë prej 475 euro që është donacion nga donatorët llapjanë (Mentor Kamerolli "Agesa", Xhafer Beselica "EuroBlok", Halit Asllani "Alumin Astra", Mr. Ph. Ekrem Bashota "Gentiana Pharm" dhe Rasim Sinani) dhe ky inventar tashmë është në pronësi të kullës.

Organizatori i Manifestimit "Dita e Plisit" është kategorik që pjesëmarrësit në këtë manifestim kudo që mbahet të vijnë të gjithë me plisa në manifestim.

Në fund Prend Buzhala në emër të autorëve të librit "Dita e Plisit" falënderoi pjesëmarrësit në përrurimin e këtyre katër librave dhe paraqiti të mbyllur manifestimin e sotëm me dëshirën që të takohen në manifestimin e radhës që do të jetë dita e tretë e edicionit të pestë dhe do të mbahet në Boletin.

Në fund organizatori i manifestimit për të gjithë pjesëmarrësit shtroi drekë me ushqime tradicionale shqiptare.

Milazim F. KADRIU



PULTI PËRKUJTON DHE FESTON

Përkujtimi i 103-vjetorit të luftës së Planit, një nder ngjarjet më të lavdishme të Dukagjinit rreth shekullit XX, kundër ushtrisë Malazeze, pat dy të veçanta, që i dhanë një panoramë shumë të këndshme festive. Në këtë manifestim festiv ishin shumë të ftuar nga Shkodra, institucionet vendore dhe nga Dukagjini. Përkujtimi i këtij përvjetori filloj me vizita në vendet historike: Te Kisha e Planit si trashëgimtare e kishës Mesjetare të hershme të Kujës në Plan, te Burimet e Kirit dhe te Kështjella e Princave Spani, në ish-qytezën e Boksit, që lan mbresa tek vizitorët, të cilët ishin të interesuar, që të mësonin rreth historisë së saj.

Kryetari i Shoqatës Patriotike Kulturore "SPANI", studiues njëkohësisht i historisë së objekteve historike të Mesjetës, i informojë të interesuarit se çfarë shkruajnë për Kështjellën e Spaneve në Qytezën e Planit Nopça, Ursini, Valentini, Kahreman Ulqini, Kole Luka e të tjerë. Nopça e Vinçenti shkruajnë 1628-ten se Plani ka një Qytet në Lagjen Boks, dhe po aty është edhe Kështjella e Spaneve. Kahreman Ulqini në Gazetën "Jeta e Re", në vitin 1973 shkruan... "Një Kala mesjetare në Boks të Planit ku muret janë me blloqe guri ku ka dhe gurët e portave dhe tri saranxhat ku janë dhe shenjat e mureve rrethuese. Gjithashtu edhe Kole Luka ne revistat filologjike 1977 shkruan: ... Për të gjitha karakteristikat e një Kalaje funksionale duke përfshirë edhe kishën brenda kalasë dhe objektet e tjera. Këto po i themi për të gjithë skeptiket, që nuk e njohin këtë objekt rreth dymijë vjeçar të pa eksploruar duke e quajtur në mënyrën ma të çuditshme dhe absurde...pike vrojtimi.

Interesante ishte edhe organizimi i panairit dhe burimeve të zonës, që u mbështeten nga Bashkia dhe vete Kryetarja Voltana Ademi si dhe nen kujdesen e Administratorit të Tome Ndo-ka, që i dhanë vlerë të shtuar këtij përkujtimi.

Ushqimet karakteristike të Traditës ishin interesante dhe shumë të shijshme. Paraqitja me prodhime bujqësore e blegtorale, ekspozita e mjeteve të punës dhe punimet e drurit ishin shumë mbresëlënëse për të pranishmit.

Koktej u shoqërua here pas here me koncertin enkas për këtë ngjarje, me këngëtarët e njohur të Trevës së Dukagjinit, Ndue Shytani, Fran Kodra, Ndoke Leka, Anila Kodra, Vjola Shqau, Sokol Gjoni si dhe humoristi Gege Shpati. Interesante ishte edhe rituali i Gjamës së Dukagjinit, e cila është kandidate për në UNESCO. Ky ritual është shumë i lashtë, por ky version është i trashëguar sipas gojëdhënës, në shenjë dhimbje, kur vdiq Gjergj Kastrioti, që gjëma është pri nga Leke Dukagjini, me djemtë e Pjeter Spanit dhe princat e tjerë. Ky ritual është paraqite në shume veprimtari në Shkodër dhe në Kosovë, që është shumë e mirëpritur, duke pas parasysh se jemi në vitin e Gjergj Kastriotit. Ky ritual është simbol i dhimbjes dhe shumë njerëz që kanë rezerva për këtë, harrojnë se të parët dhe baballarët e tyre janë varrosur me këtë ritual



dhimbje.

Udhëtimi për të gjate Luginës së Kirit zgjoj shumë premisa për zhvillimin e turizmit si një zone e virgjër dhe si binjake me Bogen dhe Thethin, por me një të veçantë në lidhje me këto vende, sepse ka burime të shumta uji dhe është shumë e pasur nga natyra me të gjitha llojet e pemëve frutore, sidomos gështenja, mol-



la, dardha, arra, qershia si dhe të gjitha llojet e florës dhe faunës.

Plani në 1915-ten nga vete pozicioni gjeografik ishte në vijën e parë të përbaljes me ushtrinë pushtuese Malazeze. Mos organizimi i forcave luftëtare të Dukagjinit, për tu përballur me ushtrinë malazeze, e gjithë pesha e luftës dhe qëndresës i mbeti luftëtareve të Plan-Gjurajve.

Në data 13-14-15-Korrik 1915 përbalja e qëndresa ishte heroike në këto dy fshatra. Babai shiftë djalit të vrare, djali shiftë babën, vëllai shiftë vëllain...por luftën se ndalonin. Fushëbeteja mbulohej nga thirrjet-Bini burra hasmit pushtues,



të mos kursejmë gjakun as jetën për këto troje të shenjta. Ky ishte motivi i luftëtareve të Plan-Gjurajve, që dhanë jetën 75-luftëtare. Për heroizmin e kësaj ngjarje na flasin dy meshtarët e kohës.

Atë Danjel Gjeçaj thotë: "Qafat u bane prita e pritat kala, dita u bë natë prej tymit të topave e të kullave të djegura, dhe nata u bë ditë nga flaket e barotit...". At Justin Rrota citon "... malsoret bajn namini mbi ushtarët malazeze...për tre dite rresht në katundet e Planit e të Gjurajve su pa gjat tjetër vetëm tym e flake, mitroloze e topa e pushke as nuk mbeti kun kulle as stan bagëtish pa u djege".

Në këtë përbalje Plani pati 75-të rene dëshmor, 300-shtëpia të djegura, 500-stane bagëtish të djegura, 5-mije koke bagëtish të therura e të plaçkitura. Hapësira e Planit u kthye në toke të djegur. Këto i bëri armiku, sepse në atë qendër mori leksionin e dështimit përfundimtar dhe të humbjes së shumë ushtarëve të mbetur, që akoma ndodhen në varrezat masive në Gropa te Streles, në Gropa të Planit, në Qafë të Megulles, Logje Kurte dhe në Bokës.

Për ta nderuar dhe përjetësuar kujtimin heroik të dëshmorëve në Korrikun e vitit 1940 u mblodh një Kuvend mbare dukagjinas me pari, krerë e meshtar dhe vendosen, që gjaku dhe jeta e këtyre dëshmoreve të përkujtohet çdo vit, në çdo 15-Korrik, në Qeresh të Planit. U punua dhe u vendos Kryqi me emrat e dëshmorëve të rene dhe u çua meshe për shpirtat e tyre, në Kishën e Shna-Ndout, në Plan, ku u shtrua dhe një dreke nga populli i Pan-Gjurajve. Në vitin 1967, në kuadrin e luftës moniste kundër fesë dhe simboleve të saj, ky kryq u hoq duke u dëmtuar krahët e tij, i cili sot ndodhet në Muzeun e Kishës Katedrale në Shkodër nen përkujdesjen e Ipeshkvit tonë, Monsiinor Angelo Massafra, që bashkësia Plan-Gjurajve gjen rastin ti shprehe mirënjohjen dhe falënderimin e tyre. Sivjet, në 103-vjetorin e Përkujtimit të kësaj Qëndrese na vjen një dhurate shumë e çmuar, Siamezi i Kryqit të 1940-te. Plani nuk mund ta linte Qereshin pa kryqin e heronjve të vet, pa simbolin e luftës së qëndresës, pa simbolin e gjakut të dëshmorëve të rene, pa simbolin e krenarisë e lavdisë dhe të dhimbjes, pa simezin e kryqit të vitit 1940-te, pa simbolin brez mbas brezi të kësaj bashkësie për kryq e flamur. Kjo dhurate erdhi nga biri fistar i Planit, Pjeter Gjoke Thani, i një shtëpie, që ka në gjak fistarine, patriotizmin, dashurinë dhe respektin për vendin e vet, që brez mbas brezi duke sakrifikuar disa jetë nga ky Trung Atdhetar. Çdo njeri që kalon në Qeresh të Planit do të përkulet para këtij Kryqi dhe dëshmorëve që përjetohen në këtë Kryq duke kujtuar lavdinë e të parëve të tyre

Në emër të bashkësisë të Plan-Gjurajve një mirënjohje e veçantë për Bashkinë Shkodër dhe Kryetaren znj. Voltana Ademi, që mundësuan këtë manifestim, në këtë ngjarje të lavdishme.

Mehill Pali

Kryetari i Shoqatës Patriotike "SPANI"

MARIN BARLETI MBI JETËN DHE VEPRAT E GJERGJ KASTRIOTI

Asnjëherë nuk është vonë për të shkruar për jetën dhe veprën e lavdishme të Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastrioti. Në këtë kuader para nesh, që nga thellësia e shekujve, shtrihet një hapësirë e pafund e memories historike, e mbushur plot luftëra e lavdi, ku në një sfond të artë, në Altarin” e saj, “banojnë” në përjetësi korifejt e ndritur të mendjes, shpatës e penës shqiptare. Një nga ata, nga më gjigandët, është prifti katolik nga Shkodra Marin Barleti, personalitet i shquar i Rilindjes Shqiptare dhe Evropiane të shekullit 15-të.

Barleti në moshën 16 vjeçare përjetoj me dhimbje vdekjen e Skënderbeut. Zotërues i disa gjuhëve të huaja, shkrimtar humanist, historian, filozof dhe luftëtar i papur i shpirtit të pamposhtur lidrashës të popullit Shqiptar. Ai luftoi me trimëri në rrethimin e parë e të dytë të Shkodrës në vitet 1474 e 1479. Me 4 prill 1479 bashkë me të tjerët shkoj në Itali, Venedik e Romë ku shkroi veprat e tij të pavdekshme. Barleti ynë u bë jo vetëm mbrojtësi, përjetonjësi dhe hymnizonjësi me i denjë i emrit e i lavdisë së atdheut të vet, por edhe një nga predikonjësit me të zjarrtë e më tërheqës të humanizmit.

Me ndenjat e zjarrta të atdhedashurisë e bindje të thellë për sakrificat që e prisnin, duke mos parë asnjë zgjidhje tjetër, ndërmer një punë kolosale për të përjetuar në shekuj jetën dhe veprën e shkëlqyer të Gjergj Kastrioti Skënderbeut.

Te libri i parë-Parathënie-në mes tjerave shkruan: “...Por, ndërsa po e ngre padyshim aqë lartë atë burrë, barra që kam marrë përsipër më rëndon e më tremb edhe më shumë, sepse unë i peshoj mirë forcat e mia dhe e kam parasysh madhësinë e punës dhe lendën e gjërë për t’u shkrojtur.” Barleti pranoi peshën e rëndë të detyrës. “Dhe, asnjë mundim apo frikë nuk do të më bëjë tanimë që të heq dorë nga të shkrojturit”. Sepse “s’ka turp më të madh mosmirënjohjeje, se sa të sillesh kësisoj me atdhenë, që, ndërsa ke mundësi ta ruash me ndonjë mënyrë nga vdekja dhe koha, të rrih me nj’anë i stepur nga që nuk mundësh, siç thonë, ta shtrish dorën në vetë burimin.” Ai kaloi shumë vështirësi dhe pengesa, të cilat i përballoi me besim, urtësi, guxim e vullnet të jashtzakonshëm: “Unë nuk pata në këtë rrugë asnjë udhëheqës, që herë të mund t’i shkonja pas, ta imitonja, herë të përpiqesha t’ia kalonja me vrullin e mëndjes, sipas shembëllës së të cilit edhe vehten time ta rregullonja, edhe rendin e atyre që duhen thënë ta trajtoja; s’pata mundësi të shikoj as anale të vjetra, as historira të reja, të cilat, një njeriut të ri dhe që hyn në një det kaqë të madh, do t’i jepnin një farë ndihme. Por, megjithë këtë, nuk dyshoj kurrëse se më pas do

të jenë të shumë ata që do të provojnë të hyjnë në rrugën e hapur me shënja më të mbara dhe me dashamirësi më të madhe të perëndive. Por sigurisht këto janë në dorë të fatit. Përkundrazi, çka më përket, unë do ta bëj pa dyshim me dorë në zemër; do të përpiqem që asnjëri të mos mundet ta akuzoj punën time as për mungesë besimi, as për plogështi, sepse unë nuk kam shkruar trillime, por ato që më kanë treguar me kujdes më të mëdhenjtë dhe ato që kanë parë me sytë e tyre që kanë marrë pjesë; dhe kam marrë parasysh besimin e shumë burrave që thonë të vërtetën dhe

NGJESHA UNË, POR JU GJETA TË ARMATOSUR, LIRINË E KISHIT KUDO, NË KRAHËROR, NË BALLË, NË SHPATË DHE NË USHTAT.”

Heroi ynë ishte i paisur me njohuri të thella të artit ushtarak. Ai shkëlqeu si strateg i shquar në fushën e betejave ushtarake. “Turqit e quajnë Skënderbeun mjeshtrin më të talentuar të pritave, luftëtarin më të madh të botës, që s’ka kush t’ia heqë fitoren nga duart. Ai është i pathyeshëm, i pamposhtur në armë, që s’merr plagë nga hekuri”. Për Skënderbeun shpejtësia, befasia, njohja e shkëlqyer e terrenit dhe

rrethimet e tjera të Krujës turqit pësuan disfata të mëdha. E gjithë Arbëria, për njëzetëepesë vjet, u bë varr i tyre.

Në letrën që Senati i Raguzës i drejtonte Janosh Huniadit në mes tjerave lexojmë: “Perandori turk bashkë me të birin mban ushtri shumë të forta në viset e Arbërisë dhe ka ngulur shatorret kundër Krujës, të cilin orvatët me të gjitha fuqitë dhe me luftë shumë të rreptë të shtjerë në dorë e ta shtyp. Në krujë janë vendosur 1500 burra shumë të aftë për mbrojtje, prandaj ushtria e lartpërmendur më kot mundohet kundër atij qyteti. Skënderbeu nuk është larg nga shatorret turke dhe për ditë e më tepër i shkakton dëme armikut.”

Shpirti luftarak i arbëresheve ishte i pamposhtur. Idriz Bitlisi, historishkrues i oborrit turk i fillimit të shekullit XVI shkruan: “Dihet, si një e një bëjnë dy, se midis popujve të Rumelisë asnjëri nuk është aq rebel dhe kokëfortë sa populli arbëresh. Arbëreshët, në sulm e në qëndresë, janë shumë të rrëmbyeshëm e të patundëshëm. Shigjetat e shtërngatës së vuajtjeve dhe të fatkeqësive, ata i presin me krahërorët e tyre të hapur dhe nuk vënë kurrë përpara armikut të tyre mburojën e dobësisë e të përlules. Vlera luftarake dhe trimëria e tyre tanimë është një fakt i provuar.” Një historian tjetër i oborrit perandorak Ibn-i Kemal tregon: “Arbëreshët,



jo vetëm traditën e parëndësi dhe të pavlerë. Kështu gjithsecili t’ua vërë mëndjen këtyre me zëmërgjërësi, me qëllim që, pasi të dalim më në fund, po desh Zoti, jasht stadiumit, t’ia fillojmë, me ndihmën e të epërmvet, punës së kërkuar prej një kohe të gjatë me aqë lutje nga njerëzit.”

Gjergji, djali më i vogël i Gjon Kastrioti, sundimtarit të Matit e Dibrës, dhe i Vojsavës vajzës plot hire e princit fisnik të Tribalëve lindi me 6 Maj 1405 dhe në moshën 9-të vjeçare u detyruar të shkojë peng në Stamboll te Sulltan Murati, ku atje kreu me rezultate të larta shkollën e Jeniçerëve dhe “Akademinë Ushtarake” si edhe mësoi shkëlqyeshëm gjuhët turke, arabe, greke, italike e sllave. Gjithashtu mori gradën e sanxhak-beut, të komandantit të një njësie administrative të perandorisë dhe u mbiquejt: “Aleksandër Zot”.

Gjergji valviti në Krujë me 28 Nëntor 1443, për herë të parë në histori, flammurin kuq e zi dhe në kulmin e entuziazmit popullor të të pranishmëve tha: “LIRINË MUND TA KISHIT FITUAR ME TRIMËRINË TUAJ EDHE ME NJË ÇLIRIMTAR TJETËR, SE ARBËRISË NUK I MUNGOJNË BURRAT. LIRINË NUK JUA SOLLA UNË PO E GJETA KËTU NË MES TUAJ. ARMËT NUK JUA

çfrytëzimi maksimal i kohës ishin faktorë me rëndësi të veçantë që përcaktonin fatin e luftës. Në këtë kuadër kishte një “mister”. Ai taktiken e bënte pasuri të të gjithëve. Ajo para se të vihej në praktikë u bëhej e njohur ushtarëve dhe oficerëve, shoshitej e pranohej me bindje prej tyre. Komandanti kurrë nuk vepronte pa u këshilluar me luftëtarët e bashkëpunëtorët e vet. “Unë s’jam nga ata, u thotë ai atyreve, që të tërheq njerëzit në rreziqe, pa ditur se ç’bëjnë.”

Në Kuvendi e Lezhës me 2 mars 1444, për herë të parë në histori, princat shqiptarë i dhanë besën njeri tjetrit për të luftuar deri në fund kundër pushtuesëve të huaj. Forcat e bashkuara nën udhëheqjen e Skënderbeut përballuan me sukses sulmet e hordhive pushtuese aziatike kundër Arbërisë, që ishte ngritur në këmbë për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë e vet. Ata korrën fitore që në betejën e parë të Tërvollit me 29 qershor 1444. Shqiptarët me Skënderbeun në krye triumfuan kundër ushtrisë turke edhe në Mokër më 1445 e në Otonetë më 1446. Në rrethimin e parë të Krujës më 1450 sulltan Murati II, duke përdorur forcat e të gjithë perandorisë, synonte likuidimin përfundimtar të rezistencës shqiptare. Nga zemërimi për disfatën e turpshme gjeti vdekjen. Edhe në

këta tigma të lufrave malore... kanë përfe kryengritjen. Edhe luftëtari më i dobët i tyre është nga më trimat në fushën e luftës, tamam sikur të ishte kalorës i hipur në kalin legjendar. Ai nuk ka as kalë as edhe mjete luftime, por ka në vend të kuajve shtiza që flakërojnë si vetëtima, ka ushta maja e të cilave është plot helm si thumbi i grerëzave, ka edhe një hark prej druri bashkë me disa shigjeta, por megjithatë ai është më i fortë se hekuri. Ata qëndronin në majat e thepisura dhe në luginat e maleve të gatshëm për të luftuar dhe vigjilentë për të vepruar në çastin e duhur.”

Kalorësi i shquar anglez Njupor me 1456 deklaronte: “Invazioni i Evropës është i sigurtë, sepse s’ka fuqi tjetër që mund ta bëjë këtë rezistencë, po të bjerë kështjella arbëreshe.” Arbëria nën udhëheqjen e Skënderbeut, pas rënies së Kostandinopolit me 1453 dhe vdekjes së Janosh Huniadit me 1456, vazhdonte të qëndronte kala e pamposhtur përballë taboreve të fuqishme të Sulltan Mehmetit II-të, i cili synonte pushtimin e Evropës pasi të shuante qëndresën heroike shqiptare.

NË KUADRIN E KONKURSIT TË "VITIT TË SKËNDERBEUT 2018"

Funksioni ushtarak i Schaputarit në shek XIV-XV dhe roli i "Rilindjes Kulturore" në dekadat e fund shek XIX për emërtimin e ri kombëtar Shqipëri *

(A kishte ekzistuar si term gjeografik - etnik - politik "Shqipëria" në kohën e bejtes së Hasan Zyko Kamberit më 1788, apo ky term u formësua më vonë përgjatë shek XIX?!)
Agron Luka

*Shënim: për shkak se ky studim është i gjatë dhe ka ilustrime grafike dokumentare, ne kemi botuar vetëm dy paragrafe dhe tre ilustrime grafike. A.L.

§ 5. Procesi i emërtimit të ri, me termin orjental "kombëtar". (~1706 - 1912)

Mbas shumë diskutimesh, "zierjeve e ngjyrosjeve në kazanin e maketeve", ishte arritur të botohej teksti zyrtar, "Historia e Shqipërisë", vëll. I, Tiranë 1959, shoqëruar më vonë edhe nga Vëllimi i i Dytë, bot. 1965, që përfshinte periudhën nga vitit 1839 - 1944.

Vetë termi Shqipëri, nuk dokumentohej të kishte ekzistuar fare in charta si emërtim territori gjeografik, etnik e politik, para vitit 1788, madje vetë ky datimi nuk kishte sigurinë e nevojshme shkencore! Kishte dyshime se, bejtja e H. Z. Kamberit ishte regjistruar e shkruar me alfabetin arab shumë më vonë se sa ai datimi i betejës turko - austriake në vargjet: "Këtë Devlet që ke tinë/inshallah të ja lësh djalit/Po të mbledhë Shqipërinë e t'i vinç hakut Nemece Kralit". Mbetej e hapur, që vetë emri Shqipëria, mund të ishte manipuluar, siç ka ngjarë rëndom me folklorin e rregulluar të kohës së Turqisë, qoftë nga mbledhësit e shkruar, qoftë nga vetë rapsodët e instruktuar! Për më tepër, kur ja ka dashur puna konspiracionistëve pan turkoshakë kanë zhdukur dhe kanë lënë pa mbledhur edhe një cikël të tërë folklori për Ballban Pashë Baderën, duke ia zhdukur e demouluar madje edhe vetë tyrben!

Në parantesë këtu duhet hapur një sqarim themelor: Aprovimi me entuziazëm i Kushtetutës së Hyrrietit më 1908, për të qëndruar të bashkuar komtarisht dhe me një unitet tokësor me vatanin ottoman dhe aprovimi i Nenit 8 si kombësi osmane, shoqëruar edhe me një seri kongresesh bashkimitare - vllaznore, krahas shumë konspiracioniteteve, kishin rrasur edhe një pshtjellim të madh në çështjen e terminologjisë, duke i barazuar si identikë termat evropiane "nacionalitet e nacion" me termat orjentalë arabo turqisht, "kavmyiet e kavm/kom(b)!" (shih, M. Logoreci, Rec. CIRKA, vj. I., Nr. 8, 6 shtatuer 1936, "Pak vrejje gjuhësore", f 114; N. Klayer, "Në fillimet e nacionalizmit shqiptar. - Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë", bot. 2012, f 585 - 592 etj.)

Në realitet këto terma nuk mund të ishin identike, si përmbajtje dhe si proces. Veprimtaria pan turko-islamike e kastës së lartë politiko-ideologjike - fetare e përkrahur edhe nga shtresa të popullsisë fanatike e injorante, arriti disa kulme përgjatë gjithë periudhës mbas vitit 1878 dhe sidomos nga 1912 - 1917, me lëvizjet e armatorura të udhëhequra nga Myftiu Musa Qazimi, Haxhi Qamili etj ... Mjaft të përmendim faktin se një pjesë e ushtrisë turke megjith komandën e lartë tinëzishit nuk doli nga territori i caktuar i Albani - Shqipërisë dhe vetë kjo Shqipëria as sot e kësaj dite, nuk ka asnjë ditë-datë qoftë edhe simbolike zyrtare çlirimi nga okupacioni më se 500 vjeçar osman - islamik

Procesi i nacionalitetit alban - epirot, ishte zhvilluar brenda territoreve të Albanisë, një

pjesë të Epirit, një pjesë të Maqedonisë dhe një pjesë të principatave ilirike/sllavojugore kufitare, nga shek XI - XV. Në shek XV, me të drejtë e gjith epopeja e Gjergj Kastriotit Skënderbeut ishte quajtur si, "lufta nacional - çlirimtare e nacionalitet - nacionit alban - epirot", bashkë me fqinjët gadishullorë dhe disa aleatë evropianë, kundra okupatorëve turko-islamë. Kjo aleancë ishte organizuar

e ribotuar edhe një herë tezën e tij: "Në gjysmën e dytë të shek XVIII emri i ri, duket e fitoi luftën në shkallë kombëtare dhe e zëvendësoi të vjetrin plotësisht. Johann Thunman, duke u mbështetur në dëshminë e voskopojarit Kostë Haxhi Jorgji Xhehani, shkroi më 1774: "populli vetë e përbuzi këtë emër dhe nuk do të emërtohet më me të. Ç'ngjau, pse e përbuzi populli i ynë emrin e vjetër në gjy-

(Prof. O. Myderrizi, e vizitonte shpesh babanë tim Gj. Luka, i cili nga viti 1963 e në vazhdim ishte i shtruar në psikiatrinë e Tiranës Ai iu lut Gjovalini t'i jepte një letër rekomandimi për botimin e një studimi te rev. Studime Historike, ku ishte si redaktor vëllai i Gjovalinit, Kol Luka shih skanimin përkatës A.L.)

Ky shkrim i prof. O. Myderrizit, një tjetër



Shpallja e Kanunderlijës/Kushtetutës së Hyrrietit dhe festimet me parullat e Bashkimxhinjve Osmanllinj, në Shkodër, më 2 gusht 1908

fillimisht me Koncilin Konfederatë të Lezhës, 1444. Ky Koncil Konfederativ Epirot - Ilirik (sllavojugor A.L.), na u interpretua i deformuar nga historiografia e shqiptarologjisë e enverologjisë si, eskluzivisht "Beslidhia Shqiptare Kombëtare e Lezhës!!!

Me thyerjen me dhunë të kësaj rezistence nacionale, me genocidimin dhe dëbimin në masë të konsiderueshme të etnisë albano - epirote, fillon një periudhë regresi dhe zbatice. Nga fillim shek XVI, fillon të fermentohet një bashkësi e re, me fe islame, me karakteristika kulturore, ideologjike, shije artistike, muzikore, në veshje etj, me përshtatje e dominim orjental. Pra, ka rinisur një proces formimi i kavmyietit dhe i një komi/kombi me fe islame.

Specifika "sui generis" e këtij kavmyietit e kavmi/kombi është se, në asnjë rast nga 1878 e në vazhdimësi, nuk ka zhvilluar ndonjë lloj programi dhe lufte nacional - çlirimtare (as kombtare - çlirimtare), me kërkesa indipendence nga Sulltanati turko-osman! Vetëm kur luftrat nacional-çlirimtare të shteteve fqinje ia prenë lidhjen territoriale dhe kordonin umbinikal me Turqinë, atëherë...

Prof. i nderuar, Osman Myderrizi, njohës i mirë i arabishtes dhe turqishtes osmanishte, në vitin 1965, e kishte rishprehur, riformuluar

smën e dytë të shek XVIII dhe adoptoi një emër të ri pa histori? Në shek XVIII ngjau një kthesë e madhe në Shqipëri. Shumica e popullit tonë për arësye të ndryshme e la krishtërimin dhe kaloi në myslimanizëm. Emri i vjetër nuk tregonte vetëm kombësinë, po edhe besimin. Me ndërrimin e besimit u ndje nevoja edhe e ndërrimit të tij. Emri i ri Shqipëtar që u adoptua si emër kombëtar, bazohej në gjuhën një nga elementet kryesore të kombësisë. Ky emër mund të jetë përdorur si emër kombëtar nga myslimanët e parë shqiptarë që në shek XVI, po këta, mbasi ishin të paktë, shumicës nuk iu imponuan dot. ... Emri kombëtar në Shqipëri u ndërrua vetëm, pse u ndërrua besimi/feja. Ndonjërit ndërrimi i emrit kombëtar për shkak besimi do t'i duket sot si një gjë e pakuptueshme..." (Rev. Stud. Hist., 1, 1965, f 164 e f 166)

Këtë ide Myderrizi e kishte afruar qysh në vitin 1933 e 1943. ("Albanopolis", rev., Minerva", nr. 11 e 15, Tiranë 1933; "Emëri i vjetër kombëtar i Shqipërisë në tekstet e vjetra shqip me alfabet latin dhe arab"; "Emri i Shqiptarëve në kohën e mesme", rev., "Hylli i Dritës", nr. 4-5 e 6-8, Shkodër, 1943)

Pavarësisht meritave të padiskutueshme, ky studim i O. Myderrizit kishte edhe të meta. Realisht emri i ri nuk bazohej në gjuhën...

shkrim i historianit Ligor Mile e madje edhe një shkrim i prof. A. Puto ("Mbi lëvizjen nacional - çlirimtare shqiptare gjatë sundimit turk", rev., St. Hist. Nr. 1, 1965, f 82-121; "Disa probleme juridike të Pavarësisë Shqiptare", f 3-17), siç na është kumtuar nga xhaxhai, mbas një rekomandimi të çensura e KQ. PPSH tërhoqën direkt vëmendjen dhe angazhimin e E. Hoxhës Ky nuk donte nga këto studime ku "vihej gishti në plagë"... sa herë që albanologjia dhe shqiptarologjia viheshin apo improvizonin "kriza ceitnoti", duheshin pritur idetë, studimet modele dialektike të shokut Enver, siç qenë ato studimet mbi Haxhi Qamilin dhe Ismail Qemalin Diktatori Enver Hoxha, po përgatitej t'i ndryshonte e t'i kamuflonte akoma më shumë këndvështrimet e historisë në kuadrin e 500 vjetorit të vdekjes së heroit nacional Gj. K. Skënderbeu.

Fillimisht, dikush si "sinjalizues vigjilent" doli të akuzonte se, termi kombëtar na ishte etiketuar si një lloj termi gogol dhe skandalizues" dhe me këtë rast ky "autoritet oportunist" rekomandonte: "termi kombëtar mund të përdoret me përparësi dhe në të gjithë literaturën, sepse atij nuk ia vriste aspak veshin të quhej Skanderbegu si, "Heroi Kombëtar"; se Kuvendi i Lezhës ishte i pari bashkim në shkallë kombëtare, për të parën herë në hi-

storinë e Shqipërisë feudale; dhe se nuk duhej të ngurrohej të qeheshin si kombëtare të gjitha lëvizjet nga Skanderbegu e Lidhja e Lezhës e tëhu..." (I. Zamputi, "Shënime mbi disa çashtje të lëvizjes çlirimtare shqiptare gjatë sundimit turk", rev., St. Hist., nr. 1, 1965, f 149 - 155)

Ky numër i Stud. Hist., vetë redaktori dhe prof. A. Buda morën vërejtje të rënda

Në vitin 1965, albanologjia dhe shqipetarologjia, morën një zotim solemn para Partisë dhe shokut Enver, se do ta zgjidhnin këtë çështje me studime multidisiplinore. "Rev, 'Ylli', 1965, shkruante: "Gjon Buzuku është i pari që e përdor fjalën 'shqip', por për të shënuar gjuhën, ndërsa për të shënuar vendin përdor fjalën Albani. Për etimologjinë e fjalës shqip janë dhënë shumë mendime, pa mundur të arrihet një zgjidhje plotësisht e pranueshme. Më i njohuri është mendimi se shqipëtarët quhen kështu nga emri i shqipes... Shqipëria u quajt 'Vëndi i shqiptonjave' dhe emri i saj u lidh me emrin e këtij shpendi. Problemi i burimit të emrit tonë të ri shqiptar vazhdon të studiohet me shumë interes nga gjuhëtarët, historianët dhe etnografët tanë. Këto forca të bashkuara do të jenë në gjendje që ta zgjidhin përfundimisht këtë problem me rëndësi kombëtare". (Rev. Ylli, Emil Lafe, "Emri kombëtar i shqiptarëve", 1965. Shih nga ne, "Rrëth shqipetarologjisë së shek XIX-XX", bot. në gazeta Shqipëria Etnike, 25 qershor 2002, f 12.)

Siç thonë, diktatori E. Hoxha, mbas disa hesapeve e konsultimeve, rekomandoi që etimologjia të bazohej te gjuha dhe jo te shpendi shqiponjë ... dhe "se sa e pastër" u ruajt gjuha tek bejtëxhinjtë myslimanët shqiptarë besoj se nuk ka nevojë as ta cekim...

Në "Konf. II të Stud. Albanologjike", janar 1968, me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së Gj. K. Skënderbeut, mbi bazën e rekomandimeve enverxohiste, e gjithë "thembra e Akilit", ishte të nxirrmin një Skënderbe, "që kishte kopjuar Enverin retrospektivisht e paradoksalisht me forcat e veta"; "një Skënderbe sa më pishmanli e shadetli, i pakënaqur e kritik ndaj gjithë Evropës, Papatit Katolik, Lidhjes Italiqe dhe Republikës Veneciane", që, "ishite gati të luftonte kundra kishës katolike e priferinjave se sa kundra turkut; se preferonte e prirëj t'ia jepte Krujën ma parë Sulltanit se sa Venedikut"! ("Konf. II, Stud. Alb.", bot.1969, Referati, A. Buda, f 39; Kumtesa S. N. Naçi, f 57-58; Kumtesa K. Biçoku, f 73, etj)

Me këtë rast diskutimesh dhe për të dalë si i parë, u fut në punë edhe autoriteti Egerem Çabej, duke ripublikuar, "Origjina e emrit Shqipëri dhe pse bota na quan Albania". [http://shekulli.com.al/origjina-e-fjales-shqipëri-dhe-pse-bota-na-quan-albania/, dt. 10.07.2017; nxjerrë nga "Studime Gjuhësore", V, 1975, f 69 -70; f 107, etj; "St. Gjsh.", III, 19, etj]

Në shkrimin konkret, prof. Çabej konkludonte: "Këto të dhëna tregojnë qartë që emri i sotëm shqiptar, Shqipëri/Shqipni, në kohë të Skënderbeut ende nuk kishte dalë, ose të paktën nuk ishte përgjithësuar, e që ky gjithësi është më i ri se emri i parë. Kjo do të thotë që emri i vjetër nacional i vendit e i popullit ka qenë arbër, arbëresh, arbënesh. E me që ky emër sikundër shihet me vështrimin e parë, është identik me Albani, Albanese etj, që u përmendën më sipër, nga të gjithë këto rezulton që shqipëtarët në mesjetë e kanë quajtur veten e tyre ashtu si quhen edhe sot te popujt e tjerë". (cit, më sipër.)

"Përsa i përket emrave shqiptar - Shqipëri, si emra populli e vendi, siç rezulton nga sa u shtjellua më sipër, këta zunë vend gjatë kohës së sundimit turk, pas shpërnguljes albane për në Greqi e Itali. Përhapje e tyre si emërtime nacionale dhe zhdukja e emrave të vjetër si të tillë, ka lidhje pas gjasash me lëvizjet etnike e sociale [...] gjatë mesjetës



Realizimi simbolgjist i idesë enverxohiste në këtë tablo, ku e gjithë historia duhet të vërtitet rreth boshtit trunor ideologjik - filozofik të pejgamberit të komunizmit orjental Enver Hoxha dhe kohës së parë turke, me shtegëtime të brendëshme me formime fisesh të reja, veçse shtysat konkrete për një zëvendësim të tillë nuk mund të ndiqen [...]; Të dy emërtimet do të kenë luftuar për shekuj me rradhë me shoqi-shoqin për përkrahjen e vet në popull, gjersa nga fundi i shek XVII emrat e rinj dolën fitues [...] ("Studime Gjuhësore", V, 1975, f 69 -70; f 107, etj);

Binte sidomos në sy pasaktësia e shprehjes, kur Çabej i quante emrat e vjetër si, "të zhdukur nga pozicioni nacional"! Në fakt emërtimi "formacioni i vjetër", më saktë formacioni tradicional Albania, me histori vazhdimësie edhe përtej K. Ptolemeut të shek II, nuk ishte zhdukur asnjëherë dhe gjithësi edhe lufta me shoqi-shoqin siç edhe imponimi, për të dalë fitues e në vendin e parë, nuk dukeshin se ishin trajtuar gjëkund nga shqipetarologjia! Edhe kur ishte kruar sapak kroshta, siç trajtimet e Myderrizit, me vrap ishin

përprjekur ta mbyllnin!

Edhe "autoriteti", mbas Çabejt, prof. Sh. Demiraj ishte shprehur: "kuptimi etimologjik i fjalës shqiptar, mbetet i errët... Ky shpjegim i lidhur me shqiponjën simbas M. Lambertit nuk është i argumentuar, sikurse nuk është i argumentuar as mendimi i G. Majerit nga lat. Excipio, që nuk qëndron. Sqarimi etimologjik i kësaj fjale mbetet i errët". ("Gjuha shqipe dhe historia e saj", 1988, f 216; shih, M. Logoreci, serial te revista Ilyrria, 1934, "Shqipia dhe Shqiptarët simbas Meyerit"; Shih edhe nga ne, Seriali, "Republika" me shqiponjën e re të mejdanit me përkrenaren e Skënder beut dhe me "Kurorën e Artë" të Dhulkarnejnit AZ, simbas Kur'an-it a.s.", bot. Shqipëria Etnike, 15 tetor 2002, f 12-130;)

Shprehjet e nënkuptuara, tendenca për t'i dhënë edhe një të shtyrë përjashtuese, shprehjet kontradiktore e kundërthënëse, luhatiet dhe lëniet hapur "as mish as peshk",

të elitës shkencore - ideologjike, në fakt ndikoheshin nga pëlqyeshmëritë dhe pozicionimi orjental i Enver Hoxhës ...

§ 6. Inercia konspirative 1990-2018...

Në periudhën e "demokracisë pluraliste anarkiste", nga viti 1990 e në vazhdim, ndodhi dhe ende po vazhdon një lloj paradoksi e regresi: organet shkencore fatkeqsisht nuk e përballuan dot vërshimin dhe urinë botuese dhe autorëve të rinj, për më tepër periodikët dhe revistat shkencore historike dolën pothuajse jashtë loje, bashkë edhe me institucionet e tyre zyrtare! Në këtë situatë shkrimet, diskutimet e studimet historike, gjuhësore etj, u botuan dhe vazhdojnë të botohen mbarë e mbrapshtë nëpër gazeta dhe aty mbesin shumica, të pa lexuara, pa asnjë seleksionim, pa asnjë shqyrtim e vlerësim dhe pa regjistrim bibliografik!

Në mënyrën më të papranueshme, filloi të ripërsëritej imitimi i kultit të individit imponues partiak - pushtetar, si diktues vije e interpretimi historik e ideologjik, mbi autoritetet shkencore!

Kategorikisht, nuk mund të ishte një revolucionar student demokrat, nga një krahinë malore, si eksperti i formë shqiponjave heraldike të Gj. K. Skënderbeut dhe të Republikës, në Kuvendin Pluralist, me formë shqiponjat në kutija bananesh...


Ndodhi në këtë periudhë kohore "tranzicioni", që dhe kur pati libra me kontribute serioze, siç ka qenë rasti me monografinë e dr. Ëngjëll Sedaj. ("Etnonimi ARBËRESH - SHQIPTAR", Prishtinë 1996), mbi këtë autor dhe mbi disa të tjerë që guxuan të sillnin prurje, interpretime e këndvështrime më realiste, ranë sulmet, ofendimet dhe kërcënimet e Rimëkëmbasve pan turq-islamike, të tipit Baleta e të myftinjve e imamëve të tipit Musa Qazimi... Ish diplomatët, prokurorët e gjyqtarët, doktorët, zyrtarët dhe ish sekretarët e K.Q të Rinisë, të gjithë "novatorët e R. Alisë, ish sigurimstat enveristë etj, tash na ishin konvertuar edhe si autoritete historie, arkeologjie, ekspertë kushtetutash evropiane etj, në PS e në PD...

Duke çfaqur një entuziazëm të tepruar dhe jo realist se, "DITA E ARBËRIT ERDHI" dhe me rastin e një prespektive si bashkim kombëtar, më 1996, dr. Sedaj (cit. f 122), propozonte rikthimin në emërtimin e formacionit Albania!

Në një simpozium në univ. L. Gurakuqi, në vitin 1998, edhe ne mbajtëm një kumtesë për anomalinë e raporteve mbi dy formacion emërtimet, atë tradicionalin nacional dhe këtë kombëtarin e privilegjuar, "Dua më shumë Shqipërinë"!

Dy vjet më vonë, Kushtetuta e Demokracisë Pluraliste e vitit 1998, nuk e gjeti asnjë rresht, asnjë fjalë, as në Preambulë e as brenda në Kushtetutë për formacion emërtimin tradicional nacional Albania! Kushtetuta e re e vitit 1998, në të gjitha diskutimet dhe varjantet paraprake, duke patur parsysh edhe një antarësim dhe integrim me Komunitetin Evropian, me hipokrizi e anashkaloi këtë diskutim...

Nuk ka llogjikë të justifikuar etj, prishia e ç'bëria e një realiteti faktik historik, siç propozonte Sedaj, por nga ana tjetër e papranueshme është që formacioni Albania, me të cilin kemi vetëprezantuar me botën e jashtme, de facto e në vazhdimësi të pandërprerë, të mbesë ende si i përzanë, ilegal dhe i pa kushtetucionalizuar!



Fotoskanim i rev. Studime Historike, nr. 1, 1965, ku me shkrimin origjinal të prof. Aleks Buda më dt. 03/V/1965 lejohet vënia në qarkullim e këtij numëri, ndaj të cilit diktatori pati bubullima, gjëmime dhe ankesa të mëdha

KUSH TË VRAU O RRROK?!

U trishtova kur mësova fundin e tmerrshëm të jetës tende!

Nuk duhej të vdisje kështu pasi nuk e meritoje një fund të tillë.

Përpara 36 vitesh të pata nxënës dhe që atëherë kurrë nuk më thirrë në emër, por profesor!

Jeta na dha drejtime krejt të ndryshme, por kur jemi takuar ndonjëherë radhe edhe nga një gotë raki e kemi pirë duke bërë romuze dashamirëse pa as një paragjykim.

Tetë fëmijë shendosh si molla dhe gota e rakisë qenë dy dashuritë e mëdha që pate risk në këto 51 vite, që u vure kapak sot.

Vdekja në shtyllën e tensionit elektrik për të mos lënë në terrin e zi të mjerimit 8 fëmijët tuaj pa as një mjet jetese veç një barake të ndërtuar nga kisha, është subjekti real made in Migjenian i një tragjedie tipike e kohërave moderne.

Në emër të kujt ju taksidarët modern të shekullit e XXI ua fiket një llambë elektrike tetë vocërrakëve të varfër, që vetëm po të shesin gjakun e trupit mund të paguanin dritat?

Në emër të kujt ju taksidarët modern të shekullit e XXI ua fiket një llambë elektrike tetë vocërrakëve të varfër dhe vetëm nga ky shkak I lat edhe jetimë pa baba?!

Ç'janë këto ligje drakoniane, çfarë janë këto reprezalje shtetërore shtazore ndaj të varfërve?!

Ju taksidarë, taksidarët modern të shekullit e XXI, hajdut të pa shpirtë të korruptuar deri në palce, burracake pa kryq pa din as iman, po të tillë jeni! Perse nuk zbatoni ligjin si për s'barthatët e xhepshpuar ashtu edhe për VIPA të hoteleve kryelartë, vilave luksoze, bizneseve të fuqishme, restoranteve, që një birrë kushton sa të ardhurat ditore të familjes së Rrok



Bregut?! Unë, ti, ai, ajo dhe çdo kush në njëjtat kondita do vepronim si ish nxënësi im i mjerë.

Në shekullin XXI, si mund lihen fëmijët duke qarë në mes të errësirës dhe komshinjtë në drita, me televizor e me internet?!

Pra, lidhim atë mut teli, u dënuam apo nuk u dënuam, vdiqëm apo shpëtuam!

Rroku ishte trim, shkeli ligjin dhe mori dënimin e merituar "vdiq si hajdut!"

Vdekje popullit "hajdut"! Rroftë e qoftë shteti hajdut!

Ti Rrok je viktima e rrallës, me numër rendore kush e di sa e sa, e një administrate të pa shpirtë dhe një sistemi shoqërorë barbar të sunduar nga katallan, që ua kanë shtrydh djer-sën e pire gjakun shqiptarëve, plaçkite vjedhur e çnderuar Shqipërinë.

Mos të guxojë kush të bëjë politike me ketë të mjerë, pasi kjo kufomë, është viktima e radhës e një kapitalizmi të pa shpirt, të pa ngopur, imoral e bythë

jashtë, i cili me majtën e pa të majtën, me djathtën e pa të djathtën, është e do mbetet i tillë i babëzitur, pavarësisht kush hipën në qerren e pushtetit. Bota, po nuk gjeti një sistem të ri, më njerëzorë dhe më human, një ditë do përfundojnë tragjikisht si Rroku në korentin elektrik. Ruajna Zot nga babëzitia e tij!

Prelë Milani

U nda nga jeta Kole Ndrezaj

Pas një sëmundjeje të gjate e të rende, dhe përpjekjeve të shumta të mjekëve italian, në klinikat më të njohura të Italisë, nuk mundi ti rezistojë sëmundjes. Ai, u nda nga jeta në një moshë mjaft të re.

Kole Gjon Ndrezaj lindi në vitin 1962, në fshatin Vuksanaj, të krahinës së Shalës. Familja e tij u shpërngul në veprat e kaskades së Drinit duke jetuar për shumë vite në Vau-Dejës dhe më pas në qytetin e Shkodrës.

Kola pasi kishte mbaruar shkollën teknike industriale, ndjeku gjurmët e babait të tij, duke punuar si teknik në hidrocentralet e Vau-Dejës dhe Koma-

nit.

Ai vinte nga një familje arsimdashëse të fshatit Vuksanaj, të krahinës së Shalës, ku ruheshin traditat më të mira të Dukagjinit.

Ndarja nga jeta ka pikëlluar pa mase prindërit e tij, në moshë të thyer, babën Gjon e nanën Drane, dhe bashkëshorten e tij, Mirelen së bashku me fëmijët, Kristjani, Xhuli e Paula, si dhe te gjithë te afërmit, miqtë, shokët.

Humbja e parakohshme e jetës së tij, ka pikëlluar pa mase koleget e bashkëpunëtorët e tij në hidrocentralin e Komanit ku punonte prej më shume se dy dekadash.

Me datën 21 gusht 2018 u bë ceremonia e varrimit të tij, në varrezat katolike Rrmaj, në Shkodër, i përcjell me nderime të mëdha nga të afërmit, miq e shoqe.

I shprehim ngushëllimet më të sinqerta, në emër të redaksisë së gazetës "Dukagjini" të gjithë familjes së Gjon Zef Shytanit!

Pushoftë në paqe!

Pergatiti per gazeten
"Dukagjini",
Zef Nika



poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi*** poezi *** poezi*** poezi *** poezi

QOFSH E RROFSH MOJ PASUNI

Dikund afër ditë për ditë
Vazhdimisht ti rri tue shitë
Unë për ty shpesh mendoj
Një nxanës shkollës i mungoj
Sepse dole atje në Zdrale
Shumë i vogël me fitue pare.

Kaloj koha ecën vitët
U bane burrë me trup u rrite
Por përsëri ke mbetë në rrugë
Te një qoshe, te një skutë
“Urdhno merrni, zotni
Janë të mira, birinxhi”.

Kështu e ka jeta, o vëlla
Shumë ushtarë dhe një pasha
Dikush matet me një shtet
Kurse tjetri s’ka lekë në xhep
Dhe i treti u mbyt në flori
Fryma i zihet qumësht tue pi
Edhe natën shtri në krevat
Thithë nektar nga çdo karat!

Po thonë pleq e të rinj:
“Qofsh e rrofsh moj pasuni!
Banu e mirë pash ata sy!
Hajde të flemë një herë me ty!
Në dashtë Zoti të kujtohesh
Bashkë me ne të martohesh!”

GJURMA

Mëngjes.....
Një shëtitje në këmbë
Gjatë bregut të detit
Cili është ai që s’e ka shijuar?
Mbi ranë pashë
Gjurmë të njerëzve të tjerë
të cilët para meje kishin kaluar.

Papritmas diçka më turbulloj!
Një mendim erdhi fluturim:
“Çdo njeri në rrugën e tij
Një gjurmë mbrapa len
Kudo dhe në çdo vend.”

Por ata i lanë shiu, era i fundos
Simbole abstrakte, paradoks!
Dalin e zhyten në pafundësi
Shkumë e detit kurdoherë mbi ujë
Si lulet që i çelë dhe i tretë pranvera
Ti do jetosh gjatë...!
Dhe mbarim s’do kesh kurrë!

Lum kush të fiton me djersë kristal!
S’ka forcë në botë që mund t’a ndal!

Njeriu është i përkohëshem, por jeta vazhdon!
Gjurma në çdo kohë mbetet jetën e njeriut pasqyron!

ZHANA D’ARK

Komandantja supreme me uniformë ushtarake
Inspektoj trupat para sulmit mbi qytetin e Orleanit
Gjeneralët synonin dobësimin e kundërshtarit!
Pushtimi i huaj vazhdonte, në letër mbetej plani!

Kur nuk mund t’i puthnin duart as këmbët
Uleshin në gjunjë pas gjurmëve të patkonjëve të kalit
Nga ndjenjat e fuqishme i mbulonin lotët e gëzimit
Dridheshin si porteka prej emocioneve të shpirtit.

Sa magjepse, e bukur si lule , plot hire ishte!
Zëri i saj kristal si tingujt e flaudit magjik!
Si Zana e malëve kreshnike menjëherë të tërhiqte!
Në moment frika mposhtej, merrte arratinë, ikte!

I denuari për “tradhëti”, arratisje nga ushtria
“Më vdiqen tre fëmijët, prej hidhërimit edhe nana
Këto ditë u nda nga jeta, më la vetëm gruaja
S’dua të jetoj më, për mua më mirë vdekja!”

“Po Franca, mos harro, ajo asht nana e jonë
Për lirinë dhe lavdinë e saj duhet të jetojmë”
“Unë dua të shërbej vetëm ty Zhna D’Ark”
Ti duhet të luftosh, për Atdheun të marim hak”

“Do të jem kurdoherë ushtari yt besnik
Okupatorin me indinjat dhe neveri e urrej
Shpata ime vdekje e tmerr për çdo armik
Deri sa t’më rrjedhë edhe një pikë gjak në dejë”

Për Shkurtabiqin Zhana D’Ark ishte, Atdhe
Pamja e ti e gjallë, përfytyrimi më i bukur
Ai qëndroj si Ante, pranë saj ra për dhe
Vdiq si trim mbi trimat, në përjetësi shkoj i lumtur.

Luigj Temali



REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti
Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra,
Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi
Botimin:
NDUE FTONI

